

PKL-KZZ 27/2010
6 gusht 2010

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS në kolegjin e përbërë nga:

Maria Giuliana Civinini Gjyqtare e EULEX-it në Gjykatën Supreme dhe Kryetare e kolegjit

Norbert Koster Gjyqtar i EULEX-it në Gjykatën Supreme – anëtar i kolegjit

Nesrin Lushta Gjyqtare në Gjykatën Supreme – anëtare e kolegjit

Emine Kaqiku Gjyqtare në Gjykatën Supreme – anëtare e kolegjit


Marie Ademi Gjyqtare në Gjykatën Supreme – anëtare e kolegjit

Ndihmuar nga Maria Rosa del Valle Lopez si procesmbajtëse në lëndën penale kundër të pandehurit:

G.G.

Lidhur me veprën penale Krime të luftës kundër popullsisë civile, në kundërshtim me Kodin Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KP të RSFJ-së), Nenin 142, lidhur me Nenin 19 për pikën b të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/59, lidhur me rregullat e ligjit ndërkombëtar në fuqi në kohë të luftës, konfliktit të armatosur ose okupimit, përkatësisht Konventën e Gjenevës për mbrojtje të civilëve në kohë të luftës, Nenet 3 dhe 147 dhe në kundërshtim me Protokollin II të Konventës së Gjenevës, Neni 4.

Duke vepruar pas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, të datës 30.10.2010 dhe të paraqitur nga përfaqësuesi ligjor i të pandehurit **G.G.** kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës P. Nr. P. 23/08, të datës 03/03/2009 si dhe Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës AP-K 191/2009, të datës 08/12/2009, lëshon këtë:



Përkthyer ng **G.G.**

AKTGJYKIM

Mbi REFUZIMIN e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë nga avokati mbrojtës i të pandehurit të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës P. Nr. P. 23/08 të datës 03/03/2009 si dhe Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës AP-K 191/2009 të datës 08/12/2009.

ARSYETIM

1. Historia procedurale

Më 3 mars 2009, Gjykata e Qarkut të Prishtinës ka shpallur fajtor [REDAKTUAR] për veprën penale Krime luftime kundër popullsisë civile, në kundërshtim me Kodin Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KP të RSFJ-së), Nenin 142, lidhur me Nenin 19 për pikën b të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/59, lidhur me rregullat e ligjit ndërkombëtar në fuqi në kohë të luftës, konfliktit të armatosur ose okupimit, përkatësisht Konventën e Gjenevës për mbrojtje të civilëve në kohë të luftës, Nenet 3 dhe 147 dhe në kundërshtim me Protokollin II të Konventës së Gjenevës, Neni 4 dhe ka dënuar të pandehurin me 17 (shtatëmbëdhjetë) vjet burgim.

Avokatët mbrojtës [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] kanë paraqitur ankesë në favor të të pandehurit më 28 prill 2009, përkatësisht më 7 maj 2009.

Më 8 dhjetor 2009, Gjykata Supreme pjesërisht ka pranuar dhe ka ndryshuar aktgjykimin e lëshuar nga Gjykata e Qarkut të Prishtinës në veçanti duke ulur dënimin e shqiptuar në 15 (pesëmbëdhjetë) vjet, duke llogaritur kohën e kaluar në paraburgim dhe duke ndryshuar disa aspekte formale të aktgjykimit.



Përkthyer nga: [REDAKTUAR]

T. 9.

██████████ si avokat mbrojtës i të pandehurit ka paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë më datën 30.10.2010 kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës P. Nr. P. 23/08 të datës 03/03/2009 si dhe Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës AP-K 191/2009 të datës 08/12/2009.

Më 19 prill 2010, Prokurori i Shtetit ka paraqitur propozimin që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, e paraqitur kundër këtyre aktgjykimeve, të hedhet poshtë si e pabazë.

Ky aktvendim vendos kërkesën e sipërpërmendur për mbrojtje të ligjshmërisë, të paraqitur nga avokati mbrojtës i të pandehurit.

2. Arsyetim

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur nga avokati mbrojtës pohon shkeljen e neneve 403.1.12 dhe 403.1.8 të KPPK-së dhe ngre tri çështje: (1) dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm, në kundërshtim me përmbajtjen e tij dhe me arsyetimin e aktgjykimit, (2) ka mospërputhje lidhur me disa çështje faktike dhe (3) avokati mbrojtës i përsërit edhe një herë pohimet e ngritura në ankesë.

Sipas avokatit mbrojtës shkeljet janë esenciale dhe pashmangshëm shpien në prishjen e aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës dhe në rigjykimin e lëndës në shkallën e Gjykatës së Qarkut.

Në nenet e mëposhtme ne do t'i analizojmë çështjet e sipërpërmendura të ngritura në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë.

2.1. Dispozitivi i aktgjykimit pohohet të jetë i pakuptueshëm, në kundërshtim me përmbajtjen e tij dhe me arsyetimin e aktgjykimit.

Avokati mbrojtës pohon se disa nga arsyetimet për faktet vendimtare përmbajnë kundërshti të



Përkthyer nga: ██████████

konsiderueshme lidhur me atë çfarë është prezantuar në arsyetimin e aktgjykimit dhe se arsyetimi nuk ka bazë të pranueshme ligjore përkitazi me faktet vendimtare.

Në pjesën tjetër Gjykata Supreme analizon secilin nga faktet e prezantuara nga avokati mbrojtës si kontradiktore dhe të pakuptueshme dhe nga kjo analizë është e qartë se edhe dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së parë edhe ai i shkallës së dytë janë plotësisht të kuptueshëm, konsekuent dhe të bazuar dhe se nuk ka mospërputhje në mes të dispozitivit dhe arsyetimit.

2.2. Mospërputhja e pohuar lidhur me disa nga çështjet faktike

Të gjitha pohimet e bëra në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë tashmë janë ngritur nga avokati mbrojtës në ankesë dhe pothuaj në të gjitha ato është dhënë përgjigje shumë e qartë dhe e kuptueshme me aktvendimin e shkallës së dytë siç do t'i shpjegojmë më poshtë:

I.O.

▪ *Koha e kryerjes së vrasjes së personit [redacted] nuk është përcaktuar: në këtë drejtim, aktgjykimi i shkallës së dytë në mënyrë të qartë e përcakton në faqen 3 të versionit në gjuhën angleze se "Gjykata Supreme në analizën e saj të aktgjykimit të ankimuar konstaton se gjykata e shkallës së parë ka konstatuar në mënyrë të saktë gjendjen faktike në përputhje me metodat juridike të faktit duke u bazuar në vlerësimin e dëshmimeve të prezantuara para Gjykatës të përshkruara si në motivimin e gjykatës. Për dallim nga ankesat gjykata e shkallës së parë vërtet ka përcaktuar të gjitha rrethanat e veprave penale mes tjerash: (...) kohën e përafërt, errësirën në kohën e kryerjes së krimit". Përveç kësaj, aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut të Prishtinës, në faqen 16, paragrafi i fundit në versionin në gjuhën angleze tregon "gjendjen faktike dhe vlerësimin e dëshmimeve: (...) në orën apo rreth orës 20:30 vetura e familjes [redacted] një Fiat Croma iu afrua pikës së kontrollit (...)". Ora pra është përcaktuar në mënyrë të përsosur në të dy aktgjykimet. Dhe, sidoqoftë avokati mbrojtës madje as nuk e përmend se pse një fakt i tillë do të ishte me rëndësi në procedurë kur tashmë në mënyrë të qartë është provuar se i pandehuri qëllimisht ka shtënë dhe ka vrarë personin [redacted]*



I.O.

Përkthyer nga [redacted]

I.O.

▪ Aktgjykimi tregon se [redacted] është qëlluar në shpinë dhe të gjitha dëshmitë tregojnë se ai ishte qëlluar në qafë: prapë, aktvendimi i shkallës së parë është jashtëzakonisht i qartë kur përshkruan trajektoren e plumbit të shkrepur nga i pandehuri, duke përfshirë hyrjen/daljen e plumbit nga trupi i të ndjerit Idriz Obrija (faqe 16, paragrafi i fundit në anglisht): [redacted] a qëlluar me armë, plumbi ka hyrë përmes dritares së pasme të veturës. Dritarja është thyer dhe plumbi ka gërvishitur [redacted] në shpinë në shpatullën e majtë, pasi që ai ishte duke u kthyer pak në të majtë për të parë se çfarë po ndodhte. Sipas të gjitha gjasave, disa copa të xhamit të dritares e qëlluan nënën e cila pësoi një plagë në buzë. Plumbi pastaj depërtoi nëpër pjesën më të sipërme të ulëses së udhëtari [redacted], doli pak më poshtë nga ana tjetër e ulëses dhe i hyri në gjoks (shpatull/qafë) [redacted], pastaj doli jashtë nga pjesa e përparme e gjoksit pak më poshtë para se ta qëllonte [redacted] në pjesën e majtë

C. 9.

S.

I. O.

I. O.

S.

I.

S.

të kokës. Ai ishte i ulur në prehrin e [redacted]. Plumbi iu fut [redacted] në kafkë dhe ngeli aty nën asht. Është vështirë të jetë dikush më i përpiktë dhe më i qartë gjatë përcaktimit të trajektores së plumbit.

Për më tepër, aktgjykimi i shkallës së parë në "Përmbledhjen e dëshmive të prezantuara"

A. R.

transkripton deklaratën e [redacted] antropolog në mjekësinë ligjore (tash Shef i Zyrës së EULEX-it për personat e pagjetur) gjatë shqyrtimit gjyqësor më 4 shkurt 2009 (faqe 6 e versionit në

R.

anglisht): z. [redacted] duke u shërbyer me një skelet për model dhe me foto sqaroi se "me autopsi ata kanë konstatuar pikën e hyrjes së plumbave të shkrepur nga arma, e cila ka qenë nga prapa. Një gjë e tillë ka qenë e mundur në bazë të mënyrës në të cilën reagon ashti ndaj shtypjes dhe se mënyra se si do të thyhet ashti përcaktohet nga përplasia me shpejtësi të madhe. Në zonën e prekur, eshtrat janë të lakuar dhe kur kjo zonë i nënshtrohet shtypjes në atë pikë do të thotë se dëmi i shkaktuar në pikën dalëse do të jetë më i madh sesa në atë hyrëse. Prandaj sa i përket hyrjes, ata mund ta përafrojnë këtë trajektore duke vendosur trajektoren e predhës ndërmjet të dy brinjëve të cilat kanë qenë të prekura. Thyerje ka edhe në ashtin e gjoksit. Kjo thyerje është shkaktuar nga i njëjti rast, trajektorja e njëjtë, që d.m.th. predha e njëjtë ka dalë jashtë afërsisht diku jashtë eshtrave. Ishte lirimi i energjisë kinetike ajo që theu ashtin. Mjeku ligjor tregon se plumbi ka depërtuar nëpër një zonë të butë kërcore, zonë




Përkthyer nga: [redacted]

kjo pa eshtra. Prandaj, në të vërtetë ata konstatuan se kjo ishte një plagë depërtuese me hyrje nga prapa në shpinë nën një kënd të ngushtë nga e majta dhe me dalje nga e djathta pak përmbi pjesën e mesme. Pika hyrëse e plumbit mund të thuhet ka qenë qafa ose kraharori pranë enëve të gjakut që lidhen me fytin (...).” Ky vendim i kundërshtuar është jashtëzakonisht i qartë dhe i bazuar mirë edhe në këtë pikë. Dhe, përsëri, avokati mbrojtës madje as që tregon pse ky fakt duhet të jetë i rëndësishëm në procedurë pasi që tashmë është provuar në mënyrë të qartë se i pandehuri qëllimisht ka shtënë dhe ka vrarë personin [REDACTED] I.O.

▪ Në Aktgjykim është përdorur shumësi “të këtyre të shtënave” përderisa arsyetimi konstaton se besohet ka qenë vetëm një e shtënë: përkritazi me këtë çështje, Gjykata Supreme konstaton se mendimi i Prokurorit të Shtetit është i bazuar; versioni shqip i aktgjykimit të shkallës së parë tregon (faqja 1, paragrafi i fundit) se: “(...) dhe për pasojë të këtyre të SHTËNAVE [REDACTED] vdiq”, ku I.O. fjala “shtënave” është forma në shumës e të shtënave. Megjithatë versioni në anglisht i aktgjykimit (faqe 1, paragrafi i fundit) tregon se “(...) [REDACTED] vdekur si rezultat i KËSAJ TË SHTËNE:” I.O. ku fjalët “kësaj të shtëne” janë qartë në numrin njëjës dhe i referohen vetëm një të shtëne (shumësi në gjuhën angleze do të ishte “këtyre të shtënave”). Duke pasur parasysh faktin se aktgjykimi origjinal është në gjuhën angleze ndërsa aktgjykimi në shqip është vetëm përkthim, versioni në anglisht mbizotëron. Prandaj, nuk ka dyshim se bëhet fjalë për gabim teknik gjatë përkthimit të dokumentit dhe për këtë arsye nuk ka kundërshti ndërmjet dispozitivit dhe arsyetimit të aktgjykimit.

5.O
▪ Vrasje e qëllimshme në tentativë e personit [REDACTED] është e pajustificuar për arsye se ai ishte qëlluar nga plumbi – predha e njëjtë e cila e vrau [REDACTED] kjo çështje është ngritur në ankesën e avokatit mbrojtës dhe tashmë Gjykata Supreme i ka dhënë përgjigje ankesës (faqe 5 të versionit në anglisht): “Gjykata Supreme pas vlerësimit të dëshmive të prezantuara në mënyrë ligjore në gjykatën e shkallës së parë, konstaton se qëllimi për të vrarë provohet me faktin se pa paralajmërim i pandehuri ka shtënë nga arma AK47 (armë e luftës) në veturë, i vetëdijshëm se vetura



Përkthyer nga [REDACTED]

ishte e mbushur me njerëz (përfshirë këtu edhe fëmijën 6 vjeç ulur në prehrin e të ndjerit) dhe duke bërë një gjë të tillë ai e ka ditur shkëlqyeshëm, duke i parë njerëzit brenda në veturë një minutë më herët, se do të vriste dhe do të lëndonte ngasësin dhe/ose udhëtarët." Kjo pikë tashmë është zgjidhur, është e bazuar në mënyrë të shkëlqyeshme dhe e kuptueshme; Gjykata Supreme nuk e konsideron të nevojshme të shtojë diçka tjetër.

H.O.

■ [REDACTED] është lënduar nga një pjesë e vogël e xhamit të dritares së pasme dhe jo nga plumbi i shkrepur nga i pandehuri: është provuar në këtë procedurë se plumbi i shkrepur nga i pandehuri ka thyer dritaren e pasme të veturës, dhe xhami i ka shkaktuar lëndime [REDACTED] (faqe 16 e versionit anglisht të aktgjykimit të shkallës së parë): [REDACTED] ka qëlluar me armë, plumbi ka hyrë përmes dritares së pasme të veturës. Dritarja është thyer dhe (...) Sipas të gjitha gjasave, disa copa të xhamit të dritares e qëlluan nënën e cila pësoi një plagë në buzë"; në këtë kuptim, i pandehuri është penalisht përgjegjës për secilën pasojë veç e veç të gjuajtjes së tij. Kjo natyrisht përfshin edhe lëndimet që i janë shkaktuar Halime Obrijës nga xhami i dritares së pasme të cilën i pandehuri e kishte thyer me rastin e gjuajtjes me armë.

H.O.
O.G.

P.O.

■ Gërvishtja në shpatullën e [REDACTED] është shkaktuar nga një granatë e hedhur nga forcat serbe dhe nuk ka lidhje me faktet: përsëri, aktgjykimi i shkallës së dytë tashmë adreson këtë çështje dhe jep përgjigje të mbështetur mirë e cila sqaron çdo dyshim të mundshëm. Aktgjykimi i shkallës së dytë tregon në faqen 3, paragrafin e fundit të versionit në anglisht se "(...) gjykata e shkallës së parë ka rikonstruktuar në mënyrë precize lëvizjet dhe veprimet e të gjithë personave të përfshirë në këtë dramë, d.m.th.: para, gjatë dhe pas shkrepjes së kësaj të shtëne si dhe pasojave të sakta të saj. Fakti që [REDACTED] ishte plagosur në një rast të mëvonshëm (nga një granatë) nuk përbën, po qe se provohet një gjë e tillë, një dëshmi të kundërt. Konstatohet pa asnjë dyshim se [REDACTED] është plagosur përmes të shtënës së shkrepur në veturë nga i pandehuri". Duke pasur parasysh qartësinë e aktgjykimit të shkallës së dytë, Gjykata Supreme nuk do të shtojë asgjë tjetër.



Përkthyer nga: [REDACTED]

2.3. Përsëritja e pohimeve të ngritura në ankesë

Avokati mbrojtës i të pandehurit tregon në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë se aktgjykimi i shkallës së dytë nuk shqyrton fare pohimet e ngritura në ankesë, prandaj, ai i përsërit edhe njëherë të njëjtat në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë.

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk ngre ndonjë pohim të ri; të gjitha tashmë janë ngritur në ankesë. Siç e kemi analizuar në pjesën e sipërme, pothuajse të gjitha janë adresuar, janë dhënë përgjigjet dhe janë shpjeguar për të pandehurin në aktgjykimet e shkallës së parë dhe të dytë.

Pohimi i vetëm i ankesës i cili nuk është përsëritur në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, është ai që avokati mbrojtës konsideron se vrasja është dashur që të cilësohet si pakujdesi dhe jo e qëllimshme. Por, përsëri, aktgjykimi i shkallës së dytë këtë çështje e zgjidh në mënyrë të qartë kur thotë se: *"Gjykata Supreme nuk pajtohet me konstatimet e ankesës sipas të cilave i pandehuri nuk kishte qëllim të vriste, as nuk kishte motiv dhe/ose kishte vepruar nga pakujdesia. Gjykata Supreme pas vlerësimit të dëshmive të prezantuara në mënyrë ligjore në gjykatën e shkallës së parë, konstaton se qëllimi për të vrarë provohet me faktin se pa paralajmërim i pandehuri ka shtënë nga arma AK47 (armë e luftës) në veturë (...) Mbrojtja, duke thënë se ky ishte një aksident, se i pandehuri dëshironte të shtinte në ajër, bën një deklaratë të paqëndrueshme për shkak të fakteve të përmendura më lart, kushteve në rrugë dhe të dhënave gjeografike. Trajektorja e plumbit (lart – poshtë) tregon qartazi se i pandehuri ka pasur si shënjestër dritaren e pasme të veturës, duke e ditur me siguri se plumbi do të depërtonte brenda pjesës së brendshme të veturës ku ishin udhëtarët."*

Prandaj Gjykata Supreme nuk ka çfarë të shtojë diçka tjetër.

Si përfundim, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur nga avokati mbrojtës është e përsëritur dhe e pabazë prandaj duhet të refuzohet.



Përkthyer nga: [REDACTED]

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
Më 6 gusht 2010, Pkl.-Kzz. Nr. 27/2010

Kryetare e kolegjit:

Maria Giuliana Civinini
Gjyqtare e EULEX-it

Procesmbajtëse:

Maria Rosa del Valle López
Zyrtare ligjore

Anëtarët e kolegjit:

Norbert Koster
Gjyqtar i EULEX-it

Emine Kaqiku
Gjyqtare e Gjykatës Supreme

Nesrin Lushta
Gjyqtare e Gjykatës Supreme

Marie Ademi
Gjyqtare e Gjykatës Supreme



Republika e Kosovës



Republika Kosovo

SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE

Punëtori i autorizuar
Gjykatçeni radnik